



Република Северна Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
AVOKATI I POPULLIT  
Republic of North Macedonia  
O M B U D S M A N

Mekanizmi Parandalues Nacional, më datë 24 dhe 27 dhjetor realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Burgun Tetovë. Vizita u realizua në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokolli Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional vizitën në Burgun Tetovë e realizoi në disa hapa, në përputhje me Rregulloren dhe Metodologjinë për Parandalimin e Torturës dhe Llojeve të tjera të Veprimit Brutal, Jonjerëzor, Përçmues ose Ndëshkues.

Ekipi i MPN hasi në bashkëpunim dhe kooperativitet nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Burgun Tetovë, të cilët mundësuan qasje papengesë në të gjitha hapësirat dhe instalimet, si dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Kapaciteti i Burgut është rreth 50 persona të dënuar, ndërsa në ditën e vizitës, konform listës së personave të dënuar, në Burg kishte 51 persona të dënuar të cilët e vuanin dënimin me burg.

Gjatë kohës së vizitës në Burgun Tetovë, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional vëmendje të veçantë u kushtoi kushteve materiale të këtij institucioni ndëshkues-korrektues dhe të gjitha kapaciteteve të vendosjes me hapësirat e tjera plotësuese dhe të jashtme.

INK – Burgu Tetovë nuk disponon me hapësira të veçante për izolim për vuajtjen e dënimit disiplinor - dërgim në izolim, kështu që si hapësira për izolim shfrytëzohen

hapësirat për seksionin e pranimit, si dhe nuk disponon me hapësirë për zbatimin e kontrollit të personave të dënuar gjatë pranimit në Institucion.

Ekipi i MPN sugjeroi se hapësira e seksionit të pranimit, e cila njëkohësisht shfrytëzohet edhe si hapësirë për ekzekutimin e dënimit disiplinor – izolim, nuk i përmbush as edhe nevojat minimale për vendosjen e personave, kështu që edhe dërgimi i personave të pranuar të ri edhe i atyre që e vuajnë dënimin disiplinor – izolim, mund të jetë veprim përçmues dhe degradues.

Në burgun Tetovë ekzistojnë 12 hapësira për paraburgim të cilat nuk shfrytëzohen për shkak se nuk i plotësojnë standardet minimale. Kjo pjesë e Burgut Tetovë, është e mbyllur me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë. Ajo që është karakteristike për të gjitha hapësirat, në të cilat ekipi i MPN ka realizuar këqyrje, është se të njëjtat nuk i përmbushin standardet e parashikuara minimale ndërkombëtare për vendosjen e personave të dënuar.

Ekipi i MPN vuri në dukje se hapësira e paraburgimit për gratë, gjithashtu është jashtë përdorimit. E njëjta shfrytëzohet për ruajtjen e sendeve dhe objekteve të ndryshme. Kushtet për vendosjen e personave janë joadekuate, ashtu siç janë edhe shumë hapësira të tjera në pjesën përdhës.

Vendosja e më shumë se 5 personave të dënuar në një hapësirë, në kundërshtim me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, çon në mungesë të privatësisë së personave të dënuar, si dhe në rritjen e rrezikut nga kërcënimet dhe dhuna.

Ekipi i MPN gjatë kohës së vizitës zhvilloi biseda individuale dhe grupore me më shumë persona të dënuar, të cilat kanë për qëllim hetimin e veprimit, përkatësisht trajtimin e personave zyrtarë ndaj të dënuarve, si dhe përcaktimin e shkallës së respektimit të të drejtave të personave të dënuar.

Personat e dënuar, me të cilët bisedoi ekipi i MPN, në përgjithësi nuk patën vërejtje sa i përket sjelljes dhe veprimit nga ana e personave zyrtarë të Burgut. Asnjë nga personat nuk u ankua për torturë ose lloj tjetër të veprimit brutal, jonjerëzor ose përçmues nga ana e të punësuarve në sektorin e sigurimit, si dhe gjithashtu asnjë nga personat e dënuar nuk ka qenë dëshmitar, e as nuk kanë dëgjuar për raste të dhunës së mundshme fizike

nga ana e shërbimit të burgut. Gjatë bisedave, të cilat ekipi i MPN i realizoi me personat e dënuar, sjelljen e të punësuarve në sektorin e sigurisë ndaj tyre, e vlerësuan si korrekte dhe sipas tyre, personat zyrtarë nuk posedojnë mjete të detyrimit.

Gjithashtu, personat e dënuar vunë në dukje se drejtori dhe eprori rregullisht kryejnë vizita në hapësirat për vendosje dhe bisedojnë me ta për problemet eventuale. Nga ana tjetër, u ankuan se fare nuk kanë takime me edukatorët e sektorit për risocializim. Ata theksuan se pjesën më të madhe të kohës e kalojnë pa përfshirje të aktiviteteve përkatëse për risocializim, kështu që aktivitetet e këtilla organizohet shumë rrallë, përkatësisht dy-tre herë në vit.

Nga bisedat e zhvilluara me personat zyrtarë, si dhe nga këqyrja në listat e personave të punësuar në Burg, në INK Burgu Tetovë nuk ka asnjë person të punësuar femër në sektorin e sigurimit. Së këtejmi, mungesa e personave të punësuar femra në sektorin e sigurimit, shpie deri në gjendjen që kontrolli ndaj personave femra – vizitues të Burgut, të mos zbatohet fare, e që nga ana tjetër e vë në pikëpyetje sigurinë e institucionit.

Në INK Burgu Tetovë nuk ka sistem funksional të thirrjes, prandaj të punësuarit në shërbimet e sigurimit kryejnë mbikëqyrje të rregullta. Nëse kanë dilema ose njohuri paraprake bëjnë kontroll, me ç'rast nuk përdorin mjete detyrimi. Nga bisedat me ta, ekipi i MPN mori informacion se gjatë bastisjeve më së shumti zbulohen telefona, bombola gazi dhe kalorifer të cilët i marrin nga jashtë. Sa i përket respektimit të rendit të shtëpisë, të punësuarit në shërbimin e sigurimit vunë në pah se në Burg ka të dënuar "partiakë të fortë" të cilët nuk e respektojnë rendin e shtëpisë.

Ekipi i MPN konstatoi se ambulanca e Burgut është shumë e vogël dhe e pajisur pamjaftueshëm me aparate mjekësore dhe ka numër të pamjaftueshëm të kuadrit mjekësor-shëndetësor në Burg.

Ekipi i MPN konstatoi se mbajtja e dokumentacionit mjekësor në Burgun Tetovë është shembull pozitiv i cili duhet të ndiqet edhe në institucionet e tjera ndëshkuese-korrektuese.

Ekipi i MPN konstatoi se për personat me sëmundje kronike, para së gjithash për ata të cilët janë diagnostifikuar me diabet, nuk përgatitet ushqim i posaçëm.

Sa i përket higjienës, ekipi i MPN konstatoi se personat kujdesen vet për higjienën e hapësirave. Gjithashtu, nga bisedat e zhvilluara me personat e dënuar, ekipi i MPN mori informacion se të njëjtët i sigurojnë vet mjetet për higjienë personale. INK shpreh shqetësim për praktikën e këtillë, veçanërisht duke i marrë parasysh rregullat ligjore në fuqi (LES), dhe në përputhje me këtë, personat e dënuar e kanë për detyrë ta mirëmbajnë higjienën personale, për çka nevojitet t'u sigurohet uji dhe pajisja për higjienë, të cilat janë të domosdoshme për mirëmbajtjen e higjienës dhe ruajtjen e shëndetit.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse drejtuar Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe drejtorit të Burgut Tetovë, me qëllim të eliminimit të mangësive dhe rreziqeve.